

INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË  
VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 29.02.2024

Të dhëna javore

Në periudhën 23-29.02.2024, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 56 raste të reja me pertusis. Numri më i madh i tyre (54) janë raportuar në Shkup, 1 në Strumicë dhe 1 në Dibër. Moshë e të prekurve sillet nga 0-70 vjet, ndërsa numri më i madh i përkasin grupmoshës 10-14 vjet (n=16).

Nga rastete e reja 3 raste janë hospitalizuar.

Të dhëna kumulative

Në vitin 2024, deri me datë 29.02.2024, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 123 raste me pertusis, me një incidencë prej 6,7/100,000 banorë.

Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit tregon se numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup - 109 (88,6%) në nëntë komuna të ndryshme, 4 të sëmurë jetojnë në Kumanovë, 5 në Tetovë, 2 në Gostivar dhe nga 1 në Strugë, Strumicë dhe Dibër.

Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, personat e prekur janë nga 1 muaj deri në 70 vjet (mesatarja 11,3 vjet). Numri më i madh i të sëmurëve janë fëmijë nën 4 vjet, gjithsej 20 raste (16,3%) ndërsa tek grupmosha nga 10-14 vjet janë regjistruar 28 raste ose (22,8%).

Rasti i parë është raportuar më 05.01.2024, ndërsa në 7 ditët e fundit janë raportuar 56 raste ose 2 herë më shumë se numri i rasteve të regjistruara deri më tani.

Sa i përket statusit të vaksinimit, 77 (62,6%) e pacientëve nuk kanë qenë të vaksinuar ose nuk i kanë pranuar të gjitha dozat sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit. 10 raste kanë qenë të vaksinuar plotësisht për moshën e tyre, për 4 raste nuk ka të dhëna për statusin e vaksinimit.

Nga të sëmurët në spital janë shtruar 27 persona (72,7%), ndërsa 22 (81,5%) prej tyre janë nën moshën 4 vjet.

Aktivitetet e realizuara për vaksinim me vaksinën e cila përmban komponentë të pertusis në Territorin e Qytetit të Shkupit dhe mbarë vendit

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Sëmundjeve Infektive dhe të Institutit të Shëndetit Publik, në periudhën nga data 18.01.2024 e deri më tani, në të gjitha pikat e vaksinimit në vend, në bashkëpunim me shërbimet epidemiologjike të QShP-së, është bërë hetim intensiv i të personave të pa evidentuar, personave të pavaksinuar dhe atyre të pavaksinuar plotësisht, si dhe personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, në mënyrë që të thirren dhe të vaksinohen sipas kalendarit kombëtar të imunizimit.

*Shkup- numri i personave të vaksinuar në periudhën 18.01-29.02.2024*

Sipas të dhënave të siguruara nga ISHP Shtëpia e Shëndetit - Shkup, nga Shërbimi i Vaksinimit nga Gazi Baba dhe Çairi, Karposh, Kisella Voda dhe Qendra, është konstatuar se janë zbuluar 13.184 fëmijë që kanë lëshuar vaksinimin, dhe prej tyre janë vaksinuar 5.056 (38,3%). Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (2.492; 49,3%).

Sipas moshës dhe Kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 7.690 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (4.729; 61,5%) e fëmijëve të vaksinuar kanë marrë dozën II të revaksinimit në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në territorin e Shkupit në periudhën prej 18.01-29.02.2024 është 12.746.

*Maqedonia e Veriut (pa Shkupin) - numri i personave të vaksinuar nga 18.01-29.02.2024*

Nga të dhënat e deritanishme të dorëzuara nga Qendrat e Shëndetit Publik, 7.143 fëmijë kanë lëshuar vaksinimin, prej të cilëve 2.164 (30,3%) janë vaksinuar. Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (1.022; 47,2%).

Sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 7.485 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (2.484; 33,2%) e të vaksinuarve kanë marrë rivaksinimin II në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në periudhën nga 18.01-29.02.2024 është 9.649.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive  
ISHPRMV